

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

RIPARIME TË PAJISJEVE
ELEKTRONIKE

Niveli II

(Në drejtimin mësimor ELEKTRONIK)

Kodi: K2-II-18

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2018

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II, të drejtimit mësimor “Elektronik”.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II.**
 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II.
- III. Plani mësimor për profilin “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II, të drejtimit “Elektronik”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II, të drejtimit “Elektronik”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me riparimet e pajisjeve elektronike.* Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Riparime të pajisjeve elektronike” niveli II, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Elektronik”, niveli I;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit në profilin “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II

Në përfundim të arsimit profesional në profilin “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të bëjë organizimin e vogël të punës në punimet e riparimeve të pajisjeve elektronike
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin teknik të profesionit.
- Të zbatojë standardet e profesionit gjatë kryerjes së punimeve
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë e të mbrojtjes së mjedisit.
- Të kryejë saktë veprimet kryesore për të dhënë ndihmën e shpejtë
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës
- Të riparojë burime ushqimi të tipeve të ndryshëm.
- Të riparojë pajisjet audio
- Të riparojë marrësin televiziv
- Të riparojë videoregjistratorin
- Të riparojë skema të ndryshme komandimi
- Të riparojë pajisje zyre elektronike

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II, e pajis nxënësin me çertifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në të gjitha bizneset që disponojnë pajisje elektronike, në pikat e tregëtimit të tyre, në pika servisi të pajisjeve elektronike, si dhe në veprimtari të tjera që veprojnë në drejtimin e elektronikës. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve elektronike.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin III (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve

universitare dhe pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II

Plani mësimor për profilin mësimor “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-10	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-12-239-11	Elektronikë	2
3	L-12-240-11	Marrësit audio dhe video	3
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-12-671-11	Riparimi i burimeve të ushqimit të pajisjeve elektronike	51
2	M-12-672-11	Riparimi i pajisjeve audio	102
3	M-12-673-11	Riparimi i marrësit televiziv	102
4	M-12-674-11	Riparimi i viedoregjistratorit	81
5	M-12-675-11	Riparimi i skemave të komandimit	36
6	M-12-676-11	Riparimi i pajisjeve elektronike të zyrës	36
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-12-677-11	Riparimi i sistemeve të alarmit	51
2	M-12-678-11	Riparimi i dekoderave satelitorë dhe tokësorë	51
3	M-12-679-11	Riparimi i pajisjeve të ndryshme elektronike	51
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/ 1054)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është **motivimi i nxënësve**. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është **integrimi i teorisë me praktikën** e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Riparime të pajisjeve elektronike”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e Elektronikës, dhe u jepet çertifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit II.

VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Riparime të pajisjeve elektronike”, niveli II, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Çertifikatën e aftësisimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit II.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-10). Kl. 12 – 68 orë

– Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjithë elementet kryesore të saj.
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore.
- Të shpjegojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes.
- Të shpjegojnë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes.
- Të përshkruajnë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të.
- Të përshkruajnë llojet e konsumatorëve, kërkesat specifike për mallra/shërbime dhe reagimet e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje.
- Të shpjegojnë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes.
- Të shpjegojnë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre.
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut.
- Të listojnë katër *P*-të e marketingut.
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit ë punës dhe elementet përbërës të tij.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës.
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen	3 orë
Tema 2	Sipërmarrja dhe aktiviteti njerëzor	4 orë
Tema 3	Sipërmarrja dhe biznesi	8 orë
Tema 4	Organizimi i punës në biznes	9 orë
Tema 5	Tregu dhe sjellja konsumatore	6 orë
Tema 6	Institucionet financiare	7 orë
Tema 7	Njohuri për Marketingun	5 orë
Tema 8	Legjislacioni dhe etika e biznesit	5 orë
Tema 9	Legjislacioni i punës	7 orë
Tema 10	Llogaritje të thjeshta ekonomike	10 orë
Tema 11	Aspekte të TIK-ut në biznes	4 orë

2. Lënda “Elektronikë” (L-12-239-11). Kl. 12 – 68 orë

– Synimet e lëndës “Elektronikë”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Elektronikë”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të analizojnë tipet e ndryshme të multivibratorëve (flip-flopeve) dhe ndryshimet midis tyre
- Të shpjegojnë funksionimin e regjistrave zhvendosës të të gjitha tipeve dhe përdorimin e tyre
- Të bëjnë analizën numëruesve sinkron dhe asinkron dhe lidhjen e tyre në kaskadë
- Të analizojnë tipet e ndryshme të memorjeve dhe përdorimet e tyre
- Të shpjegojnë fazat e procesimit të sinjalit dhe skemat e konvertimit nga analog në dixhital dhe anasjelltas.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e shndërruesve të madhësive fizike dhe elektrike
- Të shpjegojnë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e elementeve të ndjeshëm ndaj drites

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Elektronikë”, kl. 12- 68 orë:

Tema 1	Multivibratorët	14 orë
Tema 2	Regjistrat zhvendosës	10 orë
Tema 3	Numëruesat	10 orë
Tema 4	Kujtesat	8 orë
Tema 5	Procesimi i sinjalit, konvertuesit A-D dhe D-A	8 orë
Tema 6	Shndërruesit e madhësive fizike në elektrike	10 orë
Tema 7	Optoelektronika	8 orë

3. Lënda “Marrësit audio dhe video” (L-12-240-11). Kl. 12 - 102 orë

• Synimet e lëndës “Marrësit audio dhe video”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Marrësit audio dhe video”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë llojet e radiovalëve dhe veçoritë e tyre.
- Të analizojnë qarqet e ndryshme të radio-frekuencës dhe ndikimin e frekuencave në punën e perforcuesve.
- Të shpjegojnë rolin dhe veçoritë e çdo stadi në skemën-blok të radiomarrësit superheterodin me modulim në amplitudë
- Të tregojnë përparësitë e marrësit me modulim në amplitudë me mbartëse të shtypur
- Të përshkruajnë veçoritë e marrësit me modulim në frekuencë dhe funksionimin e tij.
- Të përshkruajnë karakteristikat e sinjalit televiziv si dhe sistemet e transmetimit të tij.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e bllokut të ushqimit.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e staveve të zgjedhësit të kanaleve.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e staveve të bllokut të frekuencës së mesme
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e staveve të bllokut të zërit
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e staveve të bllokut të figurës dhe kineskopit

- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e stadeve të bllokut të zbërthimit horizontal dhe vertikal
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e stadeve të bllokut të komandimit
- Të shpjegojnë veçoritë e videoregjistratorit HD.
- Të tregojnë mënyrën e ndërtimit dhe funksionimit të dekoderave tokësorë dhe satelitorë

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Marrësit audio dhe video”, kl.12- 102 orë**

Tema 1	Radiovalët.	5 orë
Tema 2	Qarqet e radiofrekuencës	10 orë
Tema 3	Radiomarrësi me modulim në amplitudë	12 orë
Tema 4	Përparësitë e transmetimit me shtypje të frekuencës mbartëse	5 orë
Tema 5	Radiomarrësi me modulim në frekuencë	8 orë
Tema 6	Transmetimi i sinjalit televiziv me ngjyra	10 orë
Tema 7	Blloku i ushqimit	4 orë
Tema 8	Blloku i zgjedhësit të kanaleve	4 orë
Tema 9	Blloku i frekuencës së mesme	6 orë
Tema 10	Blloku i zërit	4 orë
Tema 11	Blloku i figurës.	8 orë
Tema 12	Blloku i zbërthimit horizontal dhe vertikal	10 orë
Tema 13	Blloku i komandimit	4 orë
Tema 14	Marrësi televiziv HD	4 orë
Tema 15	Dekoderi tokësor dhe satelitor	8 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Riparimi i burimeve të ushqimit të pajisjeve elektronike”

Drejtimi: Elektronik
Profili: Riparime të pajisjeve elektronike
Niveli: II
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kod	RIPARIMI I BURIMEVE TË USHQIMIT TË PAJISJEVE ELEKTRONIKE	M-12-671-11
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë për të bërë kontrollin dhe riparimin e ushqyesve të pajisjeve elektronike dhe të kompjuterave personalë.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Elektronik”.	

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi riparon burimin e ushqimit të pajisjeve të ndryshme elektronike. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit të punës për riparimin e burimeve të ushqimit të pajisjeve të ndryshme elektronike.- Përzgjedhja e pajisjeve, mjeteve dhe e materialeve të punës.- Analiza e skemës elektrike të burimit të ushqimit për diagnostifikimin e defekteve- Zbërthimi i mbulesës së burimit të ushqimit- Pastrimi i pluhurit dhe papastërtive brenda pajisjes- Përcaktimi i gjendjes së elementëve në mënyrë vizive- Përcaktimi i gjendjes së elementëve me matje të ndryshme- Përcaktimi i elementëve defektozë në stade të ndryshme të burimit të ushqimit- Zëvendësimi i elementëve defektozë- Rikontrolli i punës së burimit të ushqimit- Evidentimi i gabimeve të mundshme gjatë punës- Korigjimi i gabimeve të mundshme- Mbërthimi i mbulesës së burimit të ushqimit- Kontrolli përfundimtar i punës së burimit të ushqimit- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të përcaktuar- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin.- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës- Zbatimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit
--	--

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë si duhet vendin e punës për riparimin e burimeve të ushqimit të pajisjeve të ndryshme elektronike
- të përzgjedhë drejt veglat dhe pajisjet për riparimin e burimeve të ushqimit të pajisjeve të ndryshme elektronike
- të analizojë skemën elektrike të burimit të ushqimit për diagnostifikimin e defekteve
- të zbërthejë mbulesën e burimit të ushqimit.
- të pastrojë pluhurin dhe papastërtitë brenda pajisjes
- të përcaktojë gjendjen e elementëve në mënyrë vizive
- të përcaktojë gjendjen e elementëve me matje të ndryshme
- të përcaktojë elementët defektozë në stadi të ndryshme të burimit të ushqimit
- të zëvendësojë elementët e dëmtuar duke respektuar procedurën e duhur
- të rikryejë kontrollin e punës së burimit të ushqimit
- të evidentojë ndonjë gabim të mundshëm
- të bëjë korigjimin e gabimeve të mundshme
- të mbërthejë mbulesën e burimit të ushqimit.
- të kryejë kontrollin përfundimtar të punës së burimit të ushqimit
- të hartojë preventivin për materialet në bazë të defektit të përcaktuar
- të përgatisë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit

RM 2 Nxënësi riparon ushqyesin tip çelës (SMPSU).

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës për riparimin e ushqyesit tip çelës (SMPSU).
- Përzgjedhja e pajisjeve, mjeteve dhe e materialeve të punës
- Analiza e skemës elektrike të burimit të ushqimit tip çelës
- Zbërthimi i mbulesës së pajisjes
- Pastrimi i pluhurit dhe papastërtive brenda pajisjes
- Përcaktimi i gjendjes së elementëve
- Përcaktimi i elementëve defektozë në stadi të ndryshme të burimit të ushqimit tip çelës
- Zëvendësimi i elementëve defektozë
- Rikontrolli i punës së burimit të ushqimit tip çelës
- Evidentimi i gabimeve të mundshme gjatë punës
- Korigjimi i gabimeve të mundshme
- Mbërthimi i mbulesës së burimit të ushqimit tip çelës
- Kontrolli përfundimtar i punës së burimit të ushqimit tip çelës

- Hartimi i preventivit për materiale
- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës
- Zbatimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë vendin e punës
- të për zgjedhë drejt veglat dhe pajisjet për riparimin e burimit të ushqimit tip çelës.
- të analizojë skemën elektrike të burimit të ushqimit tip çelës për diagnostifikimin e defekteve
- të zbërthejë mbulesën e pajisjes
- të pastrojë pluhurin dhe papastërtitë brenda pajisjes
- të përcaktojë gjendjen e elementëve në mënyrë vizive apo me matje të ndryshme
- të përcaktojë elementët defektozë në stade të ndryshme të burimit të ushqimit tip çelës
- të zëvendësojë elementët e dëmtuar duke respektuar procedurën e duhur
- të rikryejë kontrollin e punës së burimit të ushqimit tip çelës
- të evidentojë ndonjë gabim të mundshëm
- të bëjë korrigjimin e gabimeve të mundshme
- të mbërthejë mbulesën e burimit të ushqimit tip çelës.
- të kryejë kontrollin përfundimtar të punës së burimit të ushqimit tip çelës
- të pastrojë vendin e punës në përfundim të saj.
- të hartojë preventivin për materialet në bazë të defektit të përcaktuar
- të përgatisë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit

RM 3 Nxënësi riparon ushqyesin tip çelës për kompjuterat personalë (PC)

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës për riparimin e ushqyesit tip çelës për PC
- Përzgjedhja e pajisjeve, mjeteve dhe e materialeve të punës.
- Analiza e skemës elektrike të burimit të ushqimit tip çelës

- për PC
- Zbërthimi i mbulesës së burimit të ushqimit tip çelës për PC
 - Pastrimi i pluhurit dhe papastërtive brenda pajisjes
 - Përcaktimi i gjendjes së elementëve
 - Përcaktimi i elementëve defektozë në stade të ndryshme të burimit të ushqimit tip çelës për PC
 - Zëvendësimi i elementëve defektozë
 - Rikontroli i punës së burimit të ushqimit tip çelës për PC
 - Evidentimi i gabimeve të mundshme gjatë punës
 - Korigjimi i gabimeve të mundshme
 - Mbërthimi i mbulesës së burimit të ushqimit tip çelës për PC
 - Kontrolli përfundimtar i punës së burimit të ushqimit tip çelës për PC
 - Hartimi i preventivit për materiale
 - Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer
 - Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin.
 - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës
 - Zbatimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë si duhet vendin e punës për riparimin e ushqyesit tip çelës për PC
- të përzgjedhë drejt veglat dhe pajisjet për riparimin e burimit të ushqimit tip çelës për PC.
- të analizojë skemën elektrike të burimit të ushqimit tip çelës për PC për diagnostifikimin e defekteve
- të zbërthejë mbulesën e burimit të ushqimit tip çelës për PC
- të pastrojë pluhurin dhe papastërtitë brenda pajisjes
- të përcaktojë gjendjen e elementëve në mënyrë vizive apo me matje të ndryshme
- të përcaktojë elementët defektozë në stade të ndryshme të burimit të ushqimit tip çelës për PC.
- të zëvendësojë elementët e dëmtuar duke respektuar procedurën e duhur
- të rikryejë kontrollin e punës së burimit të ushqimit tip çelës për PC.
- të evidentojë ndonjë gabim të mundshëm
- të bëjë korigjimin e gabimeve të mundshme
- të mbërthejë mbulesën e burimit të ushqimit tip çelës për PC.
- të kryejë kontrollin përfundimtar të punës së burimit të ushqimit tip çelës për PC
- të hartojë preventivin për materialet në bazë të defektit të përcaktuar

- të përgatisë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartet dhe laboratorët e shkollës ose në pika servisi të pajisjeve elektronike.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete për përdorimin e veglave dhe të instrumenteve matëse për riparimin dhe zëvendësimin e elementëve të ndryshëm të burimeve të ushqimit të pajisjeve të ndryshme elektronike
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedisi për kryerjen e riparimeve
 - Veglat dhe aparatet e nevojshme për kontrollin dhe zëvendësimin e elementëve të veçantë të burimeve të ushqimit të pajisjeve elektronike
 - Materiale pune si: burime ushqimi të pajisjeve të ndryshme elektronike, etj
 - Udhëzuesa, rregullore, manuale teknike, fatura financiare, etj.
-

2. Moduli “Riparimi i pajisjeve audio”

Drejtimi: Elektronik
Profili: Riparime të pajisjeve elektronike
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	RIPARIMI I PAJISJEVE AUDIO	M-12-672-11
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë për të bërë kontrollin dhe zëvendësimin e elementeve të ndryshëm të radiomarrësit, magnetofonit, lexuesit të CD-ve, pultit të komandës si dhe për zëvendësimin e kasetofonit të dëmtuar në makinë.	
Kohëzgjatja e modulit	102 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Elektronik”.	

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit

RM 1 Nxënësi riparon radiomarrësin superheterodin

Përmbajtja

- Përgatitja e vendit të punës për riparimin e radiomarrësit superheterodin
- Përzgjedhja e pajisjeve, mjeteve dhe e materialeve të punës për riparimin e radiomarrësit superheterodin
- Analiza e skemës elektrike të radio-marrësit
- Zbërthimi i mbulesës së radiomarrësit
- Pastrimi i pluhurit dhe papastërtive brenda pajisjes
- Përcaktimi i gjendjes së elementëve në radiomarrës
- Përcaktimi i elementëve defektozë në stade të ndryshme
- Zëvendësimi i elementëve defektozë
- Rikontrolli i punës së radiomarrësit
- Evidentimi i gabimeve të mundshme gjatë punës
- Korigjimi i gabimeve të mundshme
- Mbërthimi i mbulesës së radiomarrësit
- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të përcaktuar
- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës
- Zbatimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë si duhet vendin e punës për riparimin e radiomarrësit superheterodin

- të përzgjedhë drejt veglat dhe pajisjet për riparimin e radiomarrësit.
- të analizojë skemën elektrike të radiomarrësit për diagnostifikimin e defekteve
- të zbërthejë mbulesën e radiomarrësit
- të pastrojë pluhurin dhe papastërtitë brenda pajisjes
- të përcaktojë gjendjen e elementëve në radiomarrës me sy ose me aparatet e duhura të matjes apo të kontrollit
- të përcaktojë elementët defektozë në stade të ndryshme
- të zëvendësojë elementët e dëmtuar duke respektuar procedurën e duhur
- të rikryejë kontrollin e punës së radiomarrësit
- të evidentojë ndonjë gabim të mundshëm
- të bëjë korigjimin e gabimeve të mundshme
- të mbërthejë mbulesën e radiomarrësit.
- të hartojë preventivin për materialet në bazë të defektit të përcaktuar
- të përgatisë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit

RM 2 Nxënësi riparon magnetofonin

Përmbajtja

- Përgatitja e vendit të punës për riparimin e magnetofonit
- Përzgjedhja e pajisjeve, mjeteve dhe e materialeve të punës për riparimin e magnetofonit
- Analiza e skemës elektrike të magnetofonit
- Zbërthimi i mbulesës së magnetofonit
- Pastrimi i pluhurit dhe papastërtive brenda pajisjes
- Përcaktimi i gjendjes së elementëve në magnetofon
- Përcaktimi i elementëve defektozë elektronikë apo mekanikë në stade të ndryshme
- Zëvendësimi i elementëve defektozë
- Rikontroli i punës së magnetofonit
- Evidentimi i gabimeve të mundshme gjatë punës
- Korigjimi i gabimeve të mundshme
- Mbërthimi i mbulesës së magnetofonit
- Kontrolli përfundimtar i punës së magnetofonit
- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të përcaktuar
- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës
- Zbatimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

- Nxënësi duhet të jetë i aftë
- të përgatitë si duhet vendin e punës për riparimin e magnetofonit
 - të përzgjedhë drejt veglat dhe pajisjet për riparimin e magnetofonit
 - të analizojë skemën elektrike të magnetofonit për diagnostifikimin e defekteve
 - të zbërthejë mbulesën e magnetofonit
 - të pastrojë pluhurin dhe papastërtitë brenda pajisjes
 - të përcaktojë gjendjen e elementëve në magnetofon me sy ose me aparatet e duhura të matjes apo të kontrollit
 - të përcaktojë elementët defektozë në stadi të ndryshme
 - të zëvendësojë elementët e dëmtuar duke respektuar procedurën e duhur
 - të rikryejë kontrollin e punës së magnetofonit.
 - të evidentojë ndonjë gabim të mundshëm
 - të bëjë korigjimin e gabimeve të mundshme
 - të mbërthejë mbulesën e magnetofonit.
 - të kryejë kontrollin përfundimtar të punës së magnetofonit
 - të pastrojë vendin e punës në përfundim të saj.
 - të hartojë preventivin për materialet në bazë të defektit të përcaktuar
 - të përgatisë faturën për shërbimin e kryer
 - të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë
 - të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit

RM 3 Nxënësi riparon lexuesin e CD (kompakt-diskun)

Përmbajtja

- Përgatitja e vendit të punës për riparimin e lexuesit të CD
- Përzgjedhja e pajisjeve, mjeteve dhe e materialeve të punës për riparimin e lexuesit të CD
- Analiza e skemës elektrike të lexuesit të CD
- Zbërthimi i mbulesës së lexuesit të CD
- Pastrimi i pluhurit dhe papastërtive brenda pajisjes
- Përcaktimi i gjendjes së elementëve
- Përcaktimi i elementëve defektozë elektronikë apo mekanikë në stadi të ndryshme
- Zëvendësimi i elementëve defektozë
- Rikontroli i punës së lexuesit të CD
- Evidentimi i gabimeve të mundshme gjatë punës
- Korigjimi i gabimeve të mundshme
- Mbërthimi i mbulesës së lexuesit të CD
- Kontrolli përfundimtar i punës së lexuesit të CD
- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të përcaktuar
- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin.

- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës
- Zbatimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

- Nxënësi duhet të jetë i aftë
- të përgatitë vendin e punës për riparimin e lexuesit të CD
- të përzgjedhë drejt veglat dhe pajisjet për riparimin e lexuesit të CD
- të analizojë skemën elektrike të lexuesit të CD për diagnostifikimin e defekteve
- të zbërthejë mbulesën e lexuesit të CD
- të pastrojë pluhurin dhe papastërtitë brenda pajisjes
- të përcaktojë gjendjen e elementëve në lexuesin e CD me sy ose me aparatet e duhura të matjes apo të kontrollit
- të përcaktojë elementët defektozë elektronikë apo mekanikë në stadi të ndryshme
- të zëvendësojë elementët e dëmtuar duke respektuar procedurën e duhur
- të rikryejë kontrollin e punës së lexuesit të CD
- të evidentojë ndonjë gabim të mundshëm
- të bëjë korigjimin e gabimeve të mundshme
- të mbërthejë mbulesën e lexuesit të CD
- të kryejë kontrollin përfundimtar të punës së lexuesit të CD
- të pastrojë vendin e punës në përfundim të saj.
- të hartojë preventivin për materialet në bazë të defektit të përcaktuar
- të përgatisë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit

RM 4 Nxënësi riparon pultin e komandës

Përmbajtja

- Përgatitja e vendit të punës për riparimin e pultit të komandës
- Përzgjedhja e pajisjeve, e mjeteve dhe e materialeve të punës për riparimin e pultit të komandës
- Analiza e skemës elektrike të pultit të komandës për diagnostifikimin e defekteve
- Zbërthimi i mbulesës së pultit të komandës
- Pastrimi i pluhurit dhe papastërtive brenda pajisjes
- Përcaktimi i gjendjes së elementëve në pult në mënyrë vizive apo me matje të ndryshme
- Përcaktimi i elementëve defektozë
- Zëvendësimi i elementëve defektozë
- Rikontrolli i punës së pultit të komandës
- Evidentimi i gabimeve të mundshme gjatë punës
- Korigjimi i gabimeve të mundshme

- Mbërthimi i mbulesës së pultit të komandës
- Kontrolli përfundimtar i punës së pultit të komandës
- Pastrimi i vendit të punës në përfundim të saj
- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të përcaktuar
- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës
- Zbatimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

- Nxënësi duhet të jetë i aftë
- të përgatitë vendin e punës për riparimin e pultit të komandës
- të përzgjedhë drejt veglat dhe pajisjet për riparimin e pultit të komandës
- të analizojë skemën elektrike të pultit të komandës për diagnostifikimin e defekteve
- të zbërthejë mbulesën e pultit të komandës
- të pastrojë pluhurin dhe papastërtitë brenda pajisjes
- të përcaktojë elementët defektozë me sy ose me aparatet e duhura të matjes apo të kontrollit
- të zëvendësojë elementët e dëmtuar duke respektuar procedurën e duhur
- të rikryejë kontrollin e punës së pultit
- të evidentojë ndonjë gabim të mundshëm
- të bëjë korigjimin e gabimeve të mundshme
- të mbërthejë mbulesën e pultit të komandës
- të kryejë kontrollin përfundimtar të punës së pultit të komandës
- të pastrojë vendin e punës në përfundim të saj.
- të hartojë preventivin për materialet në bazë të defektit të përcaktuar
- të përgatisë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit

RM 5 Nxënësi zëvendëson kasetofonin e dëmtuar në makinë

Përmbajtja

- Përgatitja e vendit të punës për zëvendësimin e kasetofonit të dëmtuar në makinë
- Përzgjedhja e pajisjeve, mjeteve dhe e materialeve të punës për zëvendësimin e kasetofonit të dëmtuar në makinë
- Analiza e skemës elektrike të lidhjes së kasetofonit në makinë
- Përcaktimi i daljeve në skemën e montimit

- Lidhja e daljeve përkatëse me bokset, masën dhe plusin e baterisë së makinës
- Rikontroli i lidhjeve
- Evidentimi i gabimeve të mundshme gjatë punës
- Korigjimi i gabimeve të mundshme
- Kontrolli përfundimtar i punës së kasetofonit të makinës
- Hartimi i preventivit për materialet e duhura
- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës
- Zbatimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

- Nxënësi duhet të jetë i aftë
- të përgatitë vendin e punës për për zëvendësimin e kasetofonit të dëmtuar në makinë
- të përzgjedhë drejt veglat dhe pajisjet për zëvendësimin e kasetofonit të dëmtuar në makinë
- të analizojë skemën elektrike të lidhjes së kasetofonit në makinë
- të përcaktojë daljet në skemën e montimit
- të lidhë daljet përkatëse me bokset, masën dhe plusin e baterisë së makinës
- të rikryejë kontrollin e lidhjes së kasetofonit në makinë
- të evidentojë ndonjë gabim të mundshëm
- të bëjë korigjimin e gabimeve të mundshme
- të kryejë kontrollin përfundimtar të punës së kasetofonit në makinë
- të hartojë preventivin për materialet
- të përgatisë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartet dhe laboratorët e shkollës ose në pika servisi të pajisjeve elektronike.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete për përdorimin e veglave dhe të instrumenteve matëse për riparimin dhe zëvendësimin e elementëve të ndryshëm të radiomarrësit, magnetofonit, lexuesit të CD, pultit të komandës si dhe për zëvendësimin e kasetofonit të dëmtuar në makinë
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë

kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedisi për kryerjen e riparimeve;
 - Veglat dhe aparatet e nevojshme për kontrollin dhe zëvendësimin e elementëve të veçantë të pajisjeve si; multimetër, oshiloskop, gjenerator sinjali, etj.
 - Mjete pune si: radiomarrës, magnetofonë, lexues CD, pulte komande, kasetofon makine dhe skemat elektrike përkatëse
 - Udhëzuesa, rregullore, manuale teknike, fatura financiare, etj.
-

3. Moduli “Riparimi i marrësit televiziv”

Drejtimi: Elektronik
Profili: Riparime të pajisjeve elektronike
Niveli: II
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	RIPARIMI I MARRËSIT TELEVIZIV	M-12-673-11
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë për të bërë riparimin e marrësive televizivë të llojeve të ndryshme	
Kohëzgjatja e modulit	102 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Elektronik”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen proceset parapërgatitore për riparimin e marrësit televiziv <i>Përmbajtja</i> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit të punës për riparimin e marrësit televiziv- Përzgjedhja e pajisjeve, mjeteve dhe materialeve të punës për riparimin e marrësit televiziv- Përcaktimi i masave të sigurisë për riparimin e marrësit televiziv- Analiza e skemës elektrike të marrësit televiziv- Zbërthimi i mbulesës së marrësit televiziv- Pastrimi i pluhurit dhe papastërtive brenda pajisjes <i>Instrumentat e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli <i>Kriteret e vlerësimit:</i> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatitë si duhet vendin e punës për riparimin e marrësit televiziv- të përzgjedhë drejt veglat dhe pajisjet për riparimin e marrësit televiziv- të përcaktojë masat e duhura të sigurisë për riparimin e marrësit televiziv- të analizojë skemën elektrike marrësit televiziv për diagnostifikimin e defekteve- të zbërthejë mbulesën e marrësit televiziv- të pastrojë pluhurin dhe papastërtitë brenda marrësit televiziv- të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit	

RM 2 Nxënësi kontrollon dhe diagnostikon defektet në marrësin televiziv

Përmbajtja

- Kontrolli me sy i skemës së marrësit televiziv
- Kontrolli me multimetër i rezistencave, diodave, transistorëve dhe kondensatorëve
- Kontrolli me oshiloskop i formave të sinjaleve në pika të ndryshme të skemës
- Kontrolli i monitorit me aparatet përkatës
- Kontrolli me dorë ose pincetë i pikave të ngjitjes së këmbëve të elementeve
- Përcaktimi i gjendjes së elementëve në marrësin televiziv
- Përcaktimi i elementëve defektozë në stade të ndryshme
- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të përcaktuar
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës
- Zbatimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë kontrollin me sy të skemës së marrësit televiziv
- të kryejë kontrollin me multimetër të rezistencave, diodave, transistorëve dhe kondensatorëve
- të kryejë kontrollin me osciloskop të formave të sinjaleve në pika të ndryshme të skemës
- të kryejë kontrollin e monitorit me aparatet përkatës
- të kryejë kontrollin me dorë ose pincetë të pikave të ngjitjes së këmbëve të elementeve
- të përcaktojë gjendjen e elementëve në marrësin televiziv
- të përcaktojë elementet defektozë në stade të ndryshme
- të hartojë preventivin për materialet në bazë të defektit të përcaktuar
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit

RM 3 Nxënësi riparon marrësin televiziv

Përmbajtja

- Zëvendësimi i rezistencave defektoze me të reja
- Zëvendësimi i diodave defektoze me të reja
- Zëvendësimi i kondensatorëve defektozë me të rinj
- Zëvendësimi i bobinave defektoze me të reja
- Zëvendësimi i transistorëve defektoze me të reja
- Zëvendësimi i qarqeve të integruar
- Rregullimi i frekuencës së rezonancës së qarqeve të hyrjes nëse ato kanë pësuar ndryshim të vlerave me mjetin përkatës
- Ngjitja e këmbëve të elementeve ose qarqeve të çngjitur
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës
- Zbatimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë zëvendësimin e rezistencave defektoze me të reja
- të kryejë zëvendësimin e diodave defektoze me të reja
- të kryejë zëvendësimin e kondensatorëve defektozë me të rinj
- të kryejë zëvendësimin e bobinave defektoze me të reja
- të kryejë zëvendësimin e transistorëve defektoze me të reja
- të kryejë zëvendësimin e qarqeve të integruar
- të kryejë rregullimin e frekuencës së rezonancës së qarqeve të hyrjes nëse ato kanë pësuar ndryshim të vlerave me mjetin përkatës
- të ngjitë këmbët e elementeve ose qarqeve të çngjitur
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit

RM 4 Nxënësi kontrollon marrësin televiziv pas riparimit

Përmbajtja

- Vënia në punë e marrësit televiziv
- Konstatimi i gjendjes së marrësit televiziv
- Kontrolli i elementeve të zëvendësuar nëse është e nevojshme
- Kontrolli i elementeve të riparuar nëse është e nevojshme
- Kontrolli i ngjitjeve të reja nëse është e nevojshme
- Kontrolli i frekuencës së rezonancës së qarqeve të hyrjes me sy ose me mjetin përkatës
- Korrigjimi i gabimeve të mundshme
- Mbërthimi i kapakut të videoregjistratorit
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës
- Zbatimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të vërë në punë marrësin televiziv
- të konstatojë gjendjen e marrësit televiziv pas riparimit
- të kryejë kontrollin e elementeve të zëvendësuar nëse është e nevojshme
- të kryejë kontrollin e elementeve të riparuar nëse është e nevojshme
- të kryejë kontrollin e ngjitjeve të reja nëse është e nevojshme
- të kryejë kontrollin e frekuencës së rezonancës së qarqeve të hyrjes me sy ose me mjetin përkatës
- të kryejë korrigjimin e gabimeve të mundshme
- të mbërthejë kapakun e videoregjistratorit
- të përgatisë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë

- profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartet ose laboratorët e shkollës ose në pika servisi të marrësve televizivë.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete për përdorimin e veglave dhe të instrumenteve matëse për riparimin dhe zëvendësimin e elementëve të ndryshëm të marrësve televizivë.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedisi për kryerjen e riparimeve;
 - Veglat dhe aparatet e nevojshme për kontrollin dhe zëvendësimin e elementëve të veçantë të marrësve televizivë si multimetër, oshiloskop, gjenerator sinjali.
 - Mjete pune si: marrësa televizivë, dioda, kondensatorë, tranzistorë, qarqe të integruara dhe pjesë të tjera për zëvendësim.
